



## Platforma Flamujt e Kuq

### Dosja e tenderit

Projekti:	Zgjidhje digjitale për integritetin në prokurim publik
Donatori:	Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM)
Implementuesi:	Demokrasi Plus
Data e fundit për ofertim:	7 qershor 2019
E-mail kontaktues:	<a href="mailto:info@dplus-ks.org">info@dplus-ks.org</a>
Kriteret e përzgjedhjes:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ofertuesi duhet të dëshmojë që ka përfunduar së paku një projekt të ngjashëm në tri vitet e fundit me vlerë së paku 5,000 euro. Projekt i ngjashëm nënkupton projekte në data scrapping.</li> <li>2. Ofertuesi duhet të ofrojë propozim teknik të detajuar se si mendon që do t'i implementojë indikatorët e dhënë.</li> <li>3. Ofertuesi duhet të paraqesë plan dinamik të detajuar për implementimin e indikatorëve.</li> </ol>
Kriteret e dhënies:	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Propozimi teknik i detajuar në bazë të kërkesave në nenin 4 (30%)</li> <li>2. Çmimi më i ulët (40%)</li> <li>3. CV-të e personelit të propozuar dhe numri i referencave për punë të ngjashme (30%)</li> </ol>
Dorëzimi i ofertave	Ofertat duhet të dorëzohen vetëm në <a href="mailto:info@dplus-ks.org">info@dplus-ks.org</a>
Afatet kohore:	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drafti i parë i platformës – 2 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës (gusht 2019)</li> <li>• Versioni final i platformës - 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës</li> </ul>

## 1. Hyrje

### 1.1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj thirrje është që të ftojë ofruesit e shërbimeve të dorëzojnë propozimet e tyre së bashku me specifikimet teknike për zhvillimin e platformës “Flamujt e Kuq”.

### 1.2 Mbulesa dhe pjesëmarrja

D+ rezervon të drejtën që të mos nënshkruajë asnjë kontratë, të shtojë apo fshijë elemente apo të ndryshojë këtë thirrje para nënshkrimit të kontratës, pa ndonjë njoftim paraprak dhe pa asnjë obligim të çfarëdo lloji ndaj asnjë pale.

## 2. Informata të përgjithshme

### 2.1 Organizata

Demokrasi Plus është organizatë joqeveritare e cila ka për mision zhvillimin e një shoqërie demokratike përmes ndikimit në vendimmarrje dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Vizioni i D+ është krijimi i një qeverisje dhe shoqërie me vlera dhe kulturë demokratike.

### 2.2 Planifikimi kohor

Afatet e poshtëshënuara tentative do të aplikohen në këtë aktivitet të prokurimit, por mund të ndryshojnë në përputhje me nevojat dhe rrethanat e paparashikuara. Në një rast të tillë këto ndryshime do t'u komunikohen përmes email të gjithë operatorëve të interesuar.

- Hapja e thirrjes (23 maj 2019)
- Pyetje dhe sqarime për ofertuesit (31 maj 2019)
- Përgjigjet nga D+ (03 qershor 2019)
- Mbyllja e thirrjes (07 qershor 2019)

## 3. Përgatitja e propozimit dhe udhëzimet

### 3.1 Kuptimi i kërkesave nga ofruesi i shërbimeve

Në përgjigje të kësaj thirrje, ofruesi i shërbimeve pranon dhe kupton të gjitha kushtet në këtë dokument, në mënyrë të plotë dhe të detajuar, përfshirë edhe sqarimet e ofruara nga D+. D+ mban të drejtën të diskualifikojë cilindo ofrues të shërbimeve i cili shfaq më pak se sa këto njohuri. Tutje D+ mban të drejtën të vendosë sipas diskrecionit nëse ofruesi i shërbimeve demonstron se e kupton tërësisht natyrën e projektit. Në rast të diskualifikimit D+ nuk mban asnjë faj, nuk mbulon asnjë kosto dhe nuk ka asnjë përgjegjësi të çfarëdollojshme.

### 3.2 Deklarata e mirëbesimit

Të gjitha informatat e siguruara nga D+ në këtë thirrje janë të ofruar në mirëbesim. Pikat individuale të kësaj thirrje mund të ndryshojnë në çdo kohë.

### 3.3 Komunikimi

Komunikimet verbale nuk do të aplikohen dhe D+ nuk merr përgjegjësi për çfarëdo informate jozyrtare që ofruesit e shërbimeve mund ta marrin. Në asnjë rast komunikimet verbale nuk do të jenë pjesë e obligimeve kontraktuale.

#### 3.3.1 Shprehja e interesit

Ofruesit e shërbimeve të interesuar për të aplikuar në këtë thirrje inkurajohen të njoftojnë D+ për interesin e tyre sa më parë që është e mundur duke dërguar një njoftim në emailin e mëposhtëm:

[info@dplus-ks.org](mailto:info@dplus-ks.org)

#### 3.3.2 Informatat dhe sqarimet shtesë

Të gjitha sqarimet shtesë të kësaj thirrje do të bëhen pjesë obligative e kontratës. Kërkesat për informata dhe sqarime të dërgohen në:

- [info@dplus-ks.org](mailto:info@dplus-ks.org)

### 3.4 Dorëzimi i ofertave

Është obligative që ofertuesit të dërgojnë propozimet e tyre në formë elektronike në email [info@dplus-ks.org](mailto:info@dplus-ks.org) deri më datën 07 qershor 2019, ora 23:59.

Ofertuesit duhet të dorëzojnë këto dokumente në mënyrë që të konsiderohen si të përgjegjshëm:

- Propozimi teknik që përfshin informacione për ofertuesin, eksperiencën në zhvillimin e projekteve të ngjashme, metodologjinë e cila do të përdoret për zhvillimin e platformës, planin dinamik të detajuar, mirëmbajtjen e platformës, qasjen për tejkalimin e problemeve teknike (bugs and risk mitigation approach), qëndrueshmërinë dhe përkrahjen teknike. Propozimi teknik duhet të jetë në përputhje me Termat e Referencës.
- Portfolio: Së paku një referencë në vlerë 5,000 euro ku ofertuesi i shërbimit ka përvujtë në zhvillim të databazave dhe uebsajteve për projekte të ngjashme. Projekte të ngjashme nënkupton "data scrapping".
- Propozimi financiar: duhet të përfshijë të gjitha kriteret më lartë si dhe kriteret e vendosura në termat e referencës. Propozimi financiar duhet të përfshijë të gjitha taksat e aplikueshme në Kosovë.
- CV-të e personelit që do të menaxhojë projektin dhe stafit teknik që do të zhvillojë platformën.

### 3.5 Kriteret e përzgjedhjes

Qëllimi i kësaj thirrje është që të identifikohen ofruesit e shërbimeve që kanë interesin, kapacitetin dhe mundësinë financiare të shërbejnë D+ me shërbimin e kërkuar në Termat e Referencës.

1	Propozimi teknik i detajuar në bazë të kërkesave në Termat e Referencës	30%
2	Çmimi më i ulët	40%
3	CV-të e personelit të propozuar dhe numri i referencave për punë të ngjashme	30%

### 3.6 Përzgjedhja dhe njoftimi

Ofruesit e shërbimeve që janë identifikuar nga D+ që kanë kapacitetin për të garuar për këtë kontratë do të përzgjedhen dhe do të kalohet në fazën e negocimit. Njoftim të shkruar do t'u dërgohet këtyre ofruesit të shërbimeve përmes emailit. Ofruesit e shërbimeve të cilët nuk janë përzgjedhur për fazën e negocimit nuk do të njoftohen.

## 4. Termat e Referencës

Flamujt e Kuq do të jetë një platformë e mbështetur nga aktiviteti Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM) dhe do të implementohet nga Demokraci Plus. Platforma Flamujt e Kuq do të integrohet në platformën prokurimihapur.org, e cila menaxhohet nga Lëvizja FOL, përmes një linku i cili të dërgon në faqen e Flamujt e Kuq.

Në Kosovë brenda një viti zhvillohen rreth 14,000 aktivitete të prokurimit, të cilat publikohen në platformën e-prokurimi. Platforma Flamujt e Kuq do të jetë një sistem sinjalizues automatik, e cila do të ju shërbejë palëve të interesuara në luftimin e korrupsionit dhe keqpërdorimeve tjera që bëhen në prokurimin publik në Kosovë. D+ synon të krijojë një algoritëm, i cili përmes indikatorëve të dhënë në pikën 4.1 do të bëjë të mundur që në mënyrë automatike të shfaqen flamuj të kuq<sup>1</sup> për një aktivitet të prokurimit. Përmes platformës Flamujt e Kuq synohet që të shfaqen të gjitha aktivitetet e prokurimit ku potencialisht mund të ketë keqpërdorime. Të dhënat do të merren nga faqja e e-prokurimit që menaxhohet nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP).

Të gjitha aktivitetet e prokurimit për të cilat algoritmi aplikon flamuj të kuq do të paraqiten në një uebfaqe të veçantë. Përdoruesit e uebfaqes do të kenë mundësinë të filtrojnë aktivitetet e prokurimit në bazë të indikatorëve, numrit të flamujve të kuq, autoriteteve kontraktuese, vlerës së parashikuar së tenderit. Uebfaqja do të mundësojë kërkim të avancuar si dhe eksportim të të dhënave në formatet e zakonshme (PDF, XLS, CSV).

### 4.1 Indikatorët për platformën Flamujt e Kuq

D+ ka identifikuar 8 indikatorë potencial, për të cilët zhvilluesi i platformës duhet që ti nxjerrë të dhënat nga e-prokurimi. Kompania që do të zhvillojë platformën do të ketë qasje në të gjitha API (Application Program Interface) që lidhen me nxjerrjen e të dhënave për indikatorët mëposhtë. KRPP do të mundësojë qasjen në të dhënat në e-prokurim përmes API (të dokumentuara ose padokumentuara), fajllave në Word, Excel dhe PDF. Indikatorët janë ndarë në indikatorë kryesorë të cilët janë obligativ për tu zhvilluar, dhe indikatorët dytësor të cilët janë të dëshirueshëm. Të gjitha të dhënat për indikatorët duhet të nxirren në mënyrë automatike. Flamujt e kuq për një aktivitet të prokurimit gjithashtu duhet të vendosen në mënyrë automatike kur të plotësohet një ose më shumë kushte sipas indikatorëve të dhënë. E vetmja ndërhyrje që mund të bëhet nga njeriu është nëse algoritmi për arsye të ndryshme e identifikon një aktivitet të prokurimit me flamur të kuq pa qenë i tillë. Kjo quhet si “false positive”, ndërsa zhvilluesi duhet që ta lejojë mundësinë që ai aktivitet i prokurimit të fshihet nga platforma Flamujt e Kuq.

---

<sup>1</sup> Flamur i kuq do të jetë një indikator i cili tregon se një shkelje e mundshme ka ndodhur në aktivitetin e prokurimit. Për shembull ka pasur vetëm një ofertë, apo se vlera e ofertës është më e lartë sesa ajo e parashikuar.

Flamujt e Kuq për Prokurim Publik		
	Indikatori	Kriteri për tu cilësuar Flamur i kuq
1	Oferta me çmimin më të ulët/pikët më të larta nuk është zgjedhur fituese	Kontrollimi nëse oferta me çmimin më të ulët apo pikët më të larta nuk është zgjedhur fituese
2	Shpërblim me kontratë i kompanive në listë të zezë apo atyre të cilat janë të papërshtatshme sipas Nenit 65	Kontrollimi i vendimeve të OSHP ku është aprovuar kërkesa për futje në listë të zezë. <a href="http://oshp.dplus-ks.org/vendimet/lista-e-zeze">http://oshp.dplus-ks.org/vendimet/lista-e-zeze</a>
3	Njoftimet pa publikim të njoftimit për kontratë (procedurë e negociuar)	Kontrollimi nëse një tender ka të publikuar njoftim për dhënie të kontratës, pa pasur njoftim për kontratë.
4	Mospublikimi i kontratës	Kontrollimi nëse është publikuar kontrata. Kontrollimi bëhet pasi të jetë publikuar njoftimi për nënshkrim të kontratës.
5	Oferta fituese mbi vlerë të parashikuar	Oferta fituese > Vlera e parashikuar
6	Kërkesa për përdorim të standardeve të vendeve tjera	Kontrollimi i tekstit në të kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional nga në të dhënat në e-prokurim ose/dhe dosjes së tenderit me një listë të standardeve të vendeve tjera të krijuar nga D+. Do të bëhet krahasimi i tekstit dhe nëse fjala përputhet (shembull standardi DIN) është flamur i kuq
7	Vetëm një ofertë e përgjegjshme në aktivitet të prokurimit	Kontrollimi i numrit të ofertave dhe nëse është vetëm një e përgjegjshme. Kjo nuk vlen kur në tender ka ofertuar vetëm një kompani.
8	Ndarja e kërkesave për tender të njëjtë	Kontrollimi nëse kërkesat e njëjta janë ndarë në tender të veçantë. Duhet të kontrollohet titulli i tenderit i një autoriteti kontraktues dhe të krahasohet a ka tender të asaj fushe apo me titull të njëjtë brenda një periudhe një mujore. Kontrolli duhet pra të bëhet një herë në muaj.

Të gjithë indikatorët kur të aplikohen kriteret e caktuara mëposhtë do të tregojnë një flamur të kuq për një aktivitet të prokurimit. Një aktivitet prokurimi mund të ketë një ose më shumë flamuj të kuq.

#### 4.2 Uebfaqja

Uebfaqja duhet të jetë e thjeshtë, e lehtë për tu përdorur dhe dizajni të reflektojë ngjyrat e faqes [prokurimihapur.org](http://prokurimihapur.org)

Të gjithë tenderët për të cilët së paku ka një flamur të kuq do të shfaqen në uebfaqe. Tenderët duhet të listohen në mënyrë kronologjike. Flamujt e kuq duhet të shfaqen anash secilit tender, ndërsa kur të afrohet mausi duhet të shfaqë indikatorin. Klikimi mbi titull të tenderit duhet të dërgojë në faqen e atij tenderi në e-prokurim, ashtu që pala e interesuar të ketë mundësi të ketë qasje edhe në dokumente tjera.

Uebfaqja duhet të ketë disa mundësi të filtrimit dhe kërkimit:

- Kërkim në tekst
- Mundësia të filtrohet në bazë të një rangu të datave kur janë publikuar tenderët
- Mundësia të filtrohet në bazë të indikatorëve
- Mundësia të filtrohet në bazë të autoriteteve kontraktuese
- Mundësia të filtrohet në bazë të vlerës së parashikuar të tenderit

- Mundësia të filtrohet në bazë të numrit të flamujve të kuq
- Mundësia të filtrohet në bazë së fituesit të tenderit.
- Mundësia që përdoruesi ti ruajë filterat dhe të njoftohet përmes email nëse ka ndonjë tender të ri me flamur të kuq sipas filterave që i ka caktuar.
- Mundësia që të dhënat të eksportohen në PDF, XLS dhe CSV (Të gjithë tenderët ose tenderët e shfaqur sipas filterave)

Në ballinë duhet të ketë një vend për një grafikun ku do të shfaqen statistika. Të dhënat që duhet të shfaqen janë:

- Totali i tenderëve me flamuj të kuq
- Rradhitja e tenderëve në bazë të numrit të flamujve të kuq
- Top 10 autoritetet kontraktuese me më së shumti flamuj të kuq
- Rradhitja e indikatorëve në bazë të numrit të flamujve të kuq
- Zhvilluesi duhet të krijojë një faqe të admin ose CMS, ku përmes saj mund të fshihen nga uebfaqja tenderët të cilët për arsye të ndryshme janë false positive

#### 4.2.1 Kriteret teknike të uebfaqes

- Platforma duhet të jetë e qasshme për të gjitha kategoritë e përdoruesve dhe të qasshme përmes pajisjeve desktop, tabletë dhe telefon. Platforma duhet të plotësojë kërkesat minimale të aksesit të përshkruara nga World Wide Web Consortium (W3C).
- Platforma duhet të jetë e shfletueshme në këta shfletues: Google Chrome, Internet Explorer, Safari, Mozilla FireFox dhe Opera.
- Platforma do të zhvillohet dhe administrohet në tri versione gjuhësore: shqip, serbisht dhe anglisht.
- Para fillimit të punës duhet të bëhet prezantimi i prototipit vizuel (mockups) që do të mundësojnë strukturimin e mëtejshëm të platformës, sipas një shablloni, si dhe përcaktimin e një identiteti vizual të platformës të bazuar në dizajnin e prokurimihapur.org.
- Sistemi i Menaxhimit të Përmbajtjes (CMS) duhet të sigurojë administrimin dhe redaktimin e përmbajtjes së faqes së platformës në një mënyrë të arritshme, efikase dhe fleksibile në mënyrë që të mënjanohet procesi i kontaktimit të kompanisë për ndryshime në platformë.
- Ofertuesi duhet të ofrojë sigurimin e shërbimeve për të parandaluar dhe luftuar rreziqet e sigurisë. Uebajti duhet të ketë edhe SSL për të paktën 1 vit.
- Serveri duhet të ketë mbrotje anti-malware.
- Platforma duhet të ketë Google Analytics për nxjerrjen e analizave mujore të Google ose raporteve të ngjashme, në lidhje me numrin e vizitave, numrin e përdoruesve unik, sipas nivelit të qasjes (User/Admin).
- Portali do të duhet të zhvillohet me këto gjuhë programuese:  
**Back End:** PHP programming language - PHP (me framework Laravel ose Codeigniter)  
**Database:** Baza e të dhënave duhet të jetë MySQL e cila do të ketë një backup javor që do të pranohet në e-mail që përcaktohet nga D+.  
**Front End:** HTML5 – JavaScript – jQuery
- Serveri ku do të vendoset platforma:  
Duhet të jetë i qas' shëm nëpërmjet IP adresës unike  
Duhet të ketë të paktën 4 GB RAM

Duhet të ketë 80 GB HDD (SSD)

Duhet të ketë mbështetje për PHP 7

Duhet të ketë cPanel (Linux-based control hosting panel)

- Domain/Subdomain
- Domaini duhet të menaxhohet nga Cloudflare dhe qasje duhen të kenë edhe stafi i D+
- Code documentation:  
Code version through GIT

#### 4.3 Detyrimet e kompanisë

Kompania ka obligim që të dorëzojë kodin burimor të algoritmave dhe të uebfaqes në momentin kur uebfaqja do të lansohet për publikun.

Kompania ka obligim që të bëjë mirëmbajtjen e uebfaqes dhe përmirësimin e gabimeve në algoritma nëse ato zbulohen pas lansimit të uebfaqes, për një periudhë 12 mujore. Periudha fillon të llogaritet pasi të bëhet lansimi publik i uebfaqes.

Kompania ka obligim që të bëjë ndryshimin, plotësimin, heqjen e ndonjë indikatorit nëse për periudhën 12 mujore pas lansimit publik të uebfaqes ka ndonjë ndryshim të ligjit dhe rregulloreve të prokurimit. Ndryshimet e tilla duhet të bëhen brenda 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të ligjit ose rregullores.

Uebfaqja duhet të jetë e hostuar në Europë dhe të ketë elemente të sigurisë (HTTPS).

#### 4.4 Detyrimet e D+

Nëse ka ndonjë ndryshim të ligjit dhe rregulloreve të prokurimit, të cilat ndikojnë në indikatorët, D+ brenda shtatë ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit ose rregullores do t'i dërgojë kompanisë indikatorin dhe kriteret për tu cilësuar si flamur i kuq. Kostoja e këtyre ndryshimeve duhet të jetë e parapërcaktuar në kontratë, si kosto opsionale nëse ndodhë një ndryshim i Ligjit të Prokurimit Publik, akteve nënligjore dhe platformës së e-prokurimit brenda një periudhe 12 mujore nga momenti i publikimit të uebfaqes.

### 5. Kriteret funksionale

#### 5.1 Afatet kohore

Ofruesi i shërbimeve duhet të dorëzojë planin dinamik të detajuar. D+ pret që një draft i parë i uebfaqes dhe së paku katër indikatorë duke funksionuar të dorëzohet jo më larg se dy muaj pas nënshkrimit të kontratës. Dizajni final duhet të dorëzohet më së largu tre muaj pas nënshkrimit të kontratës.

### 6. Kualifikimet dhe Referencat

Ofruesi i shërbimeve duhet të ofrojë informacionet e kërkuara mëposhtë në mënyrë që propozimi i tyre të konsiderohet:

- Një histori të shkurtër të kompanisë dhe shërbimeve që ofron duke përfshirë:



- emrin legal dhe adresën e kompanisë
- Dokumentet e regjistrimit
- Dëshmi që ka përfunduar me sukses së paku një projekt të ngjashëm, përmes referencave.
- CV-të e personelit të propozuar

## 7. Buxheti dhe vlera e parashikuar

Ofruesi i shërbimeve duhet të ofrojë çmimin e kryerjes së shërbimit. Ai duhet të pajtohet që çmimet e dhëna do të jenë valide për së paku 60 ditë kalendarike. Të gjitha çmimet duhet të ofrohen në euro. Nëse ka dallime në çmim për njësi dhe çmimit total, çmimi për njësi do të jetë baza për vlerësim.

## 8. Termet dhe Kushtet shtesë

### 8.1 Marrëveshja e mos zbulimit

D+ rezervon të drejtën që të kërkojë nga ofruesi i shërbimeve që të hyjë në një marrëveshje të mos zbulimit (non-disclosure agreement).

### 8.2 Kosto

Kjo thirrje nuk e obligon D+ që të paguajë për kosto të çfarëdo lloji, të cilat mund të shkaktohen nga ofruesi i shërbimeve ose palët e treta, në lidhje me përgjigjen ndaj thirrjes.

### 8.3 Jo-përgjegjësia

D+ rezervon të drejtën që të pranojë ose refuzojë ndonjë kuotim ose të ndalojë procesin e prokurimit në çdo kohë pa dhënë ndonjë arsye ose përgjegjësi. D+ nuk do të jetë përgjegjës ndaj ndonjë ofruesi të shërbimeve, personi dhe entiteti për ndonjë humbje, shpenzime, kosto, pretendime dhe dëme të çfarëdo lloji.